

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                         |
|---------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | "Humba paratë, njerëzit, gjithçka"/ Rrëfimi tronditës i Giorgos Mazonakis para vdekjes, nga konflikti me f amiljen te shtrimi në psikiatri                                                                                                              |
| ADRESA  | <a href="https://www.gazetatema.net/lifestyle/humba-parate-njerezit-gjithcka-rrrefimi-trondites-i-giorgos-mazonakis-p-i585156">https://www.gazetatema.net/lifestyle/humba-parate-njerezit-gjithcka-rrrefimi-trondites-i-giorgos-mazonakis-p-i585156</a> |
| BURIMI  | gazetatema.net                                                                                                                                                                                                                                          |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                                  |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 10 shtator 2026, 11:17:21 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 10 shtator 2026, 11:15:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | d12ed66a53cc3bdcd9248f473a80a3ae6b90f04a00665a6c59d6551840fc43c1 |
| TEKSTI     | 2279ce95608042435bf6e9ea60e73e623c3b21ef20b57c39ff58f209b152edf6 |
| PAMJA      | 96b9f42b3d62254276386783bc4c0d86d8c33de2771749c1c5990e5a4f2caa75 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|                |                                                                                                 |
|----------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE      | 02b8f20544e65a505f64c339b48a39dbfd2fcf2109f72cad6be9c384ed847db8                                |
| E MËPARSHMJA   | —                                                                                               |
| RRËNJJA MERKLE | d35bf96e2e2477ebd2106ee1d9fe097322df12c64ad1eb4eebbbfad377b409db                                |
| ANKORIMI       | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/02b8f20544e65a505f64c339b48a39dbfd2fcf2109f72cad6be9c384ed847db8>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie "Humba paratë, njerëzit, gjithçka"/ Rrëfimi tronditës i Giorgos Mazonakis para vdekjes, nga konflikti me familjen te shtrimi në psikiatri118 milione euro për Durrësin - B fundit

## "Humba paratë, njerëzit, gjithçka"/ Rrëfimi tronditës i Giorgos Mazonakis para vdekjes, nga konflikti me familjen te shtrimi në psikiatri



10 Shtator 2026, 13:15Lifestyle TEMA



Vetëm dy muaj para vdekjes së tij të papritur, Giorgos Mazonakis kishte rrëfyer publikisht për periudhën më të vështirë të jetës së tij, duke folur për konfliktin me familjen, humbjet financiare, shkëputjen nga njerëzit e afërt dhe shtrimin e pavullnetshëm në spitalin psikiatrik Dromokaiteio.

Intervista e dhënë në emisionin "Tet-a-Tet" në muajin korrik ishte ajo që do të rezultonte të ishte intervista e fundit televizive e këngëtarit grek. Pas vdekjes së tij në moshën 54-vjeçare, mediat greke kanë rikthyer në vëmendje rrëfimin ku ai fliste hapur për gjithçka kishte kaluar gjatë vitit të fundit.

Një nga temat kryesore ishte marrëdhënia e tij me familjen dhe veçanërisht me motrën Vasso, me të cilën kishte pasur edhe një marrëdhënie profesionale.

Mazonakis tregoi se përplasjet kishin nisur pas një mosmarrëveshjeje lidhur me një pronë. Sipas tij, motra kishte pasur prokurë, por situata ishte komplikuar dhe gradualisht marrëdhënia mes tyre ishte kthyer në një konflikt të madh.

"Besoj 100% se kam edhe unë përgjegjësi për atë që ndodhi me familjen time", kishte thënë këngëtari, duke pranuar se gjatë kësaj periudhe kishte zbuluar shumë gjëra për veten dhe mënyrën se si kishte përjetuar marrëdhëniet me të afërmit.

Ai tregoi se dikur nuk do ta kishte imagjinuar kurrë se do të arrinte në pikën që të mos fliste më me familjen.

"Familja filloi të shembej brenda meje. Jam njeri i familjes", ishte një tjetër prej rrëfimeve të tij, teksa shpjegonte se situata ishte bërë gjithnjë e më e rëndë.

Mazonakis foli edhe për momentin kur familjarët shkonin në shtëpinë e tij pa u lajmëruar, duke thënë se sipas tij ata nuk vinin për të bërë paqe, por për t'i thënë se gjërat që ai pretendonte nuk ishin të vërteta.

Përplasia nuk kishte mbetur vetëm në nivelin familjar. Këngëtari kishte paralajmëruar edhe hapa ligjorë, ndërsa kishte deklaruar se çështja lidhur me shtrimin e tij të pavullnetshëm në Dromokaiteio do të ndiqej në rrugë ligjore. Ai përmendi edhe një padë prej 1 milion eurosh.

**"Humba paratë, njerëzit, gjithçka"**

Në një prej momenteve më të forta të intervistës, Mazonakis foli për humbjet që kishte pësuar gjatë kësaj periudhe.

Ai tregoi se për vite me radhë kishte dëgjuar këshillat për të mos bërë biznes me të afërmit, por nuk i kishte marrë seriozisht.

Më pas, sipas tij, problemet kishin sjellë humbje jo vetëm financiare.

“Humba para. U përfshinë edhe bashkëpunëtorë të tjerë, jo vetëm familja. Humbën të gjitha, edhe njerëzit, edhe paratë, gjithçka”, ishte rrëfimi i këngëtarit.

Ai tregoi se periudha kishte qenë aq e rëndë sa kishte ndier sikur po humbiste kontrollin mbi jetën e tij.

***Si përfundoi në Dromokaiteio***

Mazonakis kishte folur gjatë edhe për ditën kur dy oficerë policie me rroba civile u shfaqën në shtëpinë e tij dhe i thanë se duhej të shkonte në Dromokaiteio.

Sipas rrëfimit të tij, ai ishte duke gatuar në momentin kur policia mbërriti. Ai hëngri, bëri dush dhe më pas u nis me makinën e policisë drejt spitalit.

Këngëtari tha se fillimisht nuk e kishte kuptuar se çfarë po ndodhte dhe shpresonte se nuk do të mbahej në spital.

Por qëndrimi atje nuk ishte i lehtë për të.

Ai rrëfeu se kishte pasur frikë nga mënyra se si do ta trajtonin njerëzit në klinikë dhe se përjetoi ndjenja të forta frike dhe tradhtie.

“U bëra atraksioni i Dromokaiteios”, kishte treguar ai, duke kujtuar edhe reagimet e disa prej personave që ndodheshin aty.

Mazonakis tha se ajo që e shqetësonte më shumë ishte ndikimi që e gjithë situata mund të kishte mbi karrierën e tij.

Ai gjithashtu mohoi se kishte menduar ndonjëherë se ishte rrezik për veten dhe tha se ende përiqej të kuptonte se përse familja kishte ndërmarrë atë hap.

***“Gjaku bëhet ujë”***

Pavarësisht konfliktit, këngëtari kishte deklaruar se nuk do të pushonte së dashuruari familjen e tij.

Ai tregoi se babai kishte mbajtur një qëndrim neutral dhe se, edhe pse ishte i lënduar dhe i distancuar emocionalisht, vazhdonte të kishte një shpresë se gjërat mund të ndryshonin.

Në një tjetër moment, ai tha se nuk u përgjigjej më telefonatave të familjarëve, pasi sipas tij, çdo herë që kishte tentuar të komunikonte, situata kishte përfunduar në të njëjtën mënyrë.

Mazonakis kishte folur edhe për ndikimin psikologjik që kishte pasur gjithë kjo situatë tek ai.

Ai tregoi se kishte kaluar shumë stres dhe se kishte kryer edhe një ndërhyrje urgjente për heqjen e fshikëzës së tëmthit. Sipas tij, e kishte kuptuar se gjithçka që po përjetonte do të ndikonte në një mënyrë ose në një tjetër edhe në shëndetin e tij.

“Po filloja të humbisja tokën nën këmbë”, kishte rrëfyer këngëtari.

***Vdekja e papritur***

Giorgos Mazonakis ndërroi jetë më 9 shtator, në moshën 54-vjeçare, pasi pësoi arrest kardiak në një klinikë private në Kolonaki.

Sipas raportimeve të Proto Thema, ai kishte shkuar në klinikë për një trajtim të planifikuar me plazmaferezë. Gjatë përgatitjes për procedurën, pasi iu vendos një kateter venoz, ai raportohet se ndjeu dhimbje të forta në gjoks dhe më pas pësoi arrest kardiak.

Stafi i klinikës dhe më pas ekipet e emergjencës tentuan ta reanimonin, ndërsa këngëtari u transportua në spitalin “Elpis”, ku u konstatua vdekja.

Brethanat e sakta të vdekjes po hetohen dhe deri tani nuk është përcaktuar një lidhje shkakësore mes trajtimit të planifikuar dhe arrestit kardiak.

Ndërkohë, intervista e tij e fundit televizive, ku ai fliste për familjen, paratë, humbjet dhe periudhën e vështirë në Dromokaiteio, tashmë është rikthyer në qendër të vëmendjes pas vdekjes së tij.

Një rrëfim që, vetëm pak javë më vonë, merr një tjetër peshë: “Humba paratë, njerëzit, gjithçka”.

Burimi: Proto Thema



Lini një Përgjigje

Koment \*

Emër \*

POSTOJE KOMENTIN

[Shifrat marramendëse të CEO-ve/ Nga Tim Cook te Elon Musk, ja sa miliona e miliarda fitojnë](#)

12:26 Lifestyle

Dua Lipa dhe Callum Turner shkëlqejnë në New York, tërheqin vëmendjen në eventin e Bvlgari

11:31 Lifestyle



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.